

Rreth nesh

EVN Elektrodistribucioni është Kompani, veprimtaria kryesore e së cilës është distribuimi i energjisë elektrike në Maqedoni. Në tregun e Maqedonisë kompania hyri në vitin 2006, si pjesë e Grupacionit EVN i cili është aktiv në 21 shtete në Evropën Qendrore, Lindore dhe Juglindore. Objektiva jonë kryesore është furnizimi i sigurtë dhe kualitativ i konsumatorëve me energji elektrike dhe çmime konkurente.

KARRIERA NË EVN

SAP EKSPERT PËR LAJMËRIM (M/F)

Përshkrim i detyrave në punë

- Mbështetje profesionale të proekteve vendase dhe ndërkombëtare brenda kornizave të Grupacionit EVN
- Analizë, specifikim, konceptim dhe optimizim të IT projekteve nga fusha e Business Intelligence
- Menaxhim i kërkesave të konsumatorëve në kuadër të departamenteve të punës
- Zhvillim, modifikim, mirëmbajtje dhe mbështetje të raporteve custom
- Sigurim të sistemit të kualitetit dhe dokumentim i të njejtit (krijim dhe mirëmbajtje të dokumentacionit teknik për sisteme të ndryshme, shërbime dhe biznes procese duke i përfshirë bazat e të dhënave dhe procedurat për raporte)
- Ndihmë gjatë shqyrtimit, konsolidimit dhe zvogëlimit të dallimeve në të dhënat
- Gjetja dhe definimi i mundësive të reja për përmirësim të proceseve
- Bashkëpunim me kompani të jashtme për mbështetje dhe mirëmbajtje, specifikim të kërkesave, mbikqyrje të zhvillimit si dhe testim dhe integrim me aplikacione të tjera.
- Trajnim të konsumatorëve përfundimtarë.

Kualifikimet e nevojshme dhe karakteristikat personale

- Përvojë pune të dëshmuar si data/reporting analyst
- Përvojë teknike me modele të të dhënave
- 3-5 vite përvojë në zhvillim, përshtatje dhe implementim të mjeteve BI (njohuri të SAP BI/BW do të llogariten si përparësi)
- Përvojë në formulim të pyetësorëve, krijim të raporteve dhe prezantim të rezultateve
- Njohje të proceseve të departamenteve të punës

Kompetencat

- Integrim të informatave nga burime të ndryshme të të dhënave
- Aftësi të larta analitike, me aftësi për mbledhje, organizim, analizë dhe shpërndarje të nivelit të konsiderueshëm të informatave, me precizitet dhe vëmendje ndaj detajeve.
- Të përkushtuar ndaj rezultateve
- Organizim të lartë
- Fokus në komunikim të shkëlqyer të brendshëm dhe të jashtëm me klient
- Aftësi për menaxhim të më shumë projekteve nga fusha të ndryshme funksionale njëkohësisht

Nëse jeni të interesuar për karrierë në EVN Maqedoni, dërgoni biografinë Tuaj të shkurtër dhe letër motivuese në jobs.evnelektrodistribucija@evn.mk ose plotësoni aplikimin elektronik në faqen tonë të internetit www.evn.mk

Vërejtje: Në pajtueshmëri me Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale, nëse dëshironi që të dhënat Tuaja të ruhen në data bazën tonë, përveç CV-së Tuaj dhe letrës motivuese duhet të dërgoni edhe deklaratë për leje shfrytëzimi të të dhënave personale për nevojat e punësimit (<https://www.evn.mk/Careers/OnlineApplication.aspx>)